

FINANCA

Buletina Maja | QERSHOR 2026



AKTI NORMATIV PËR BUXHETIN 2026, MINISTRI MALAJ: RRISIM MBËSHETJEN SOCIALE DHE FINANCIMET PËR SEKTORËT PRIORITARË TË EKONOMISË

Si rezultat i ecurisë pozitive të ekonomisë në pesë muajt e parë të vitit, Ministria e Financave hartoi aktin normativ për ndryshimin e buxhetit 2026. Në komunikimin pas mbledhjes së qeverisë, Ministri Petrit Malaj informoi se

përmes aktit normativ do të financohen disa politika të rëndësishme që synojnë: forcimin e mbështetjes për shtresat më në nevojë; rritjen e investimeve në shëndetësi; përmbushjen e angazhimit të Shqipërisë në kuadër të NATO-s, si dhe zgjerimin e Garancisë Sovrane, për të mbështetur jo vetëm fermerët, por edhe bizneset e vogla e të mesme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ndër masat kryesore janë afrimi i indeksimit të pensioneve, dyfishimi i pagesës për fëmijët me aftësi të kufizuara, financime shtesë për barnat onkologjike dhe mbrojtjen, si dhe zgjerimi i Garancisë Sovrane deri në 5 miliardë lekë.

LEXO MË SHUMË

PERFORMANCA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-MAJ 2026

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Maj 2026 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën Janar-Maj 2026, arritën në rreth 340.5 miliardë lekë ose me realizim 105.3 % të planit të periudhës, ndërsa

krahasuar me Janar-Maj 2025 u rritën me rreth 34.3 miliardë lekë ose 11.2 % më shumë. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 5 mujore të vitit 2026, arritën në rreth 286.8 miliardë lekë me një realizim në masën 96.8% të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 ky zë ka rezultuar 7.4% më i lartë ose rreth 19.7 miliardë lekë më shumë.

LEXO MË SHUMË



SHQIPËRIA SHËNON PROGRES TË RËNDËSISHËM NË TRANSPARENÇËN BUXHETORE, RENDITET NDËR PERFORMUESIT MË TË MIRË NË RAJON

Shqipëria ka shënuar përmirësimin në fushën e transparencës buxhetore, sipas rezultateve të Anketës së Buxhetit të Hapur 2025, të publikuar nga Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit. Vendi ka arritur 64 pikë në treguesin e transparencës buxhetore, më i larti në Ballkanin Perëndimor, me një rritje prej 7 pikësh krahasuar me vitin 2023, duke kaluar për herë të parë pragun prej 61 pikësh. Progresi reflekton angazhimin e vazhdueshëm të Ministrisë së Financave për forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit me publikun në procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit.

LEXO MË SHUMË



MINISTRIA E FINANCEVE HAP KONSULTIMIN PUBLIK TË PROJEKTLIGJIT "PËR KËSHILLIN FISKAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Ministria e Financave ka hapur konsultimin publik të projektligjit "Për Këshillin Fiskal të Republikës së Shqipërisë", një nismë e rëndësishme që synon forcimin e kuadrit institucional të qeverisjes fiskale dhe rritjen e transparencës në menaxhimin e financave publike. Projektligji parashikon krijimin e

Këshillit Fiskal si një institucion të pavarur, me mandat të qartë ligjor, i cili do të monitorojë zbatimin e rregullave fiskale, do të vlerësojë politikat fiskale dhe do të analizojë parashikimet makroekonomike dhe buxhetore. Përmes këtij mekanizmi synohet të forcohet ndarja ndërmjet funksionit të hartimit të politikave dhe atij të vlerësimit të tyre, duke rritur objektivitetin, besueshmërinë dhe transparencën e procesit të vendimmarrjes.

LEXO MË SHUMË



MALAJ ME SHEFIN E MISIONIT TË FMN-SË, DISKUTIME MBI ECURINË EKONOMIKE

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një takim me Shefin e Misionit të FMN për Shqipërinë, z. Diego Cerdeiro, me të cilin diskutoi mbi ecurinë e ekonomisë shqiptare, e cila ka vijuar të rritet me ritme pozitive të qëndrueshme. Ministri

Malaj vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë dhe konstruktiv me FMN-në, duke nënvizuar rëndësinë e mbështetjes së institucionit në hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike dhe fiskale që garantojnë stabilitetin dhe zhvillimin afatgjatë të vendit. Nga ana e tij, z. Cerdeiro vlerësoi progresin e Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe rëndësinë e vijimit të politikave të kujdesshme fiskale dhe reformave që mbështesin rritjen ekonomike të qëndrueshme.

LEXO MË SHUMË



FORCIMI I SIGURISË DOGANORE, MINISTRI MALAJ INSPEKTON INVESTIMIN NË SISTEMET E MONITORIMIT NË BLLATË

Ministri i Financave, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave dhe Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, vizitoi Degën Doganore Bllatë, ku pa nga afër investimin për modernizimin e sistemeve të monitorimit në pikat kufitare. Ministri Malaj vlerësoi mbështetjen britanike, duke theksuar se investimi prej 1.6 milionë paundësh, i financuar përmes Home Office, shtrihet në 11 pika doganore dhe kontribuon në forcimin e sigurisë kufitare dhe modernizimin e administratës doganor. Nga ana e tij, Ambasadori z. Nicholas Abbott vlerësoi bashkëpunimin me autoritetet shqiptare si një model të suksesshëm partneriteti në forcimin e sigurisë kufitare dhe luftën kundër aktiviteteve të paligjshme, duke theksuar rezultatet pozitive të arritura gjatë viteve të fundit.

LEXO MË SHUMË



MINISTRI MALAJ TAKOHET ME MISIONIN E ASISTENCËS TEKNIKE TË FMN PËR ANALIZËN E SISTEMIT TË FINANCEVE VENDORE

Ministri i Financave zhvilloi një takim me misionin e asistencës teknike të FMN-së, i cili vizitoi Tiranën në periudhën 10-22 qershor 2026 për të analizuar sistemin e financave dhe taksave vendore, si dhe ndarjen e të ardhurave tatimore ndërmjet qeverisë qendrore dhe pushtetit vendor. Gjatë takimit u diskutuan masat për forcimin e qëndrueshmërisë së financave vendore, rritjen e autonomisë financiare të bashkive dhe avancimin e reformës së taksës së pronës. Ministri Malaj vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të FMN-së dhe theksoi rëndësinë e rekomandimeve të ekspertëve për përmirësimin e kuadrit të financave vendore dhe forcimin e qeverisjes vendore në Shqipëri.

LEXO MË SHUMË

ZËVENDËSMINISTRI ENDRIT YZEIRAJ NË TAKIMIN VJETOR TË BERZH

Zëvendësministri Endrit Yzeiraj mori pjesë në Takimin Vjetor të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), i cili u zhvillua në Riga të Letonisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të vendeve aksionare, institucioneve financiare

ndërkombëtare dhe sektorit privat. Zëvendësministri vlerësoi partneritetin e qëndrueshëm mes Shqipërisë dhe BERZH-it, duke theksuar rolin e rëndësishëm që banka ka luajtur në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Ai ftoi përfaqësuesit e vendeve aksionare dhe pjesëmarrësit e tjerë të vizitojnë Tiranën në vitin 2028, kur Shqipëria do të mirëpresë Takimin Vjetor të BERZH-it.

LEXO MË SHUMË



ZËVENDËSMINISTRI MEMETI NË MBLEDHJEN E DYTË TË KOMITETIT MONITORUES TË FACILITETIT PËR REFORMA DHE RITJE

Zëvendësministri Andi Memeti mori pjesë në mbledhjen e dytë të Komitetit Monitorues të Facilitetit për Reforma dhe Rritje, ku u shqyrtua

progresi i Shqipërisë në zbatimin e Agjendës së Reformave dhe angazhimet e ndërmarra në kuadër të procesit të integritimit evropian. Z. Memeti evidentoi masat e ndërmarra nga MF për krijimin e strukturave të dedikuara për zbatimin e RFG, integrimin e mbështetjes financiare të RGF-së në kuadrin buxhetor kombëtar, forcimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit financiar, si dhe ngritjen e mekanizmave efektivë të raportimit dhe monitorimit.

LEXO MË SHUMË